

VENDIM
Nr. 258, datë 10.10.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDRO ENERGY SOTIRA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “e”, të nenit 5, pika 1 germa “e”, të nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1 germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1755/2 prot., datë 3.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Hydro Energy Sotira’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hydro Energy Sotira” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1720 prot., datë 17.9.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Hydro Energy Sotira” sh.p.k. ka plotësuar kërkesat e rregullores, duke dokumentuar informacion në zbatim të nenit 9, pikës 1.1, gjerat “a”, “b”, “c”; pikës 1.2, gjerat “a”, “d”; pikës 1.3, germa “b” dhe pikës 2.5.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni si vijon:

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- germa “b”: Aplikuesi duhet të depozitojë edhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore për shoqërinë “Hydro Energy Sotira” sh.p.k.;

- germa “c”: Aplikuesi duhet të informojë ERE-n, në lidhje me funksionin që kryejnë operatorët, në kuptim të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- germa “a”: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Elbasan, në lidhje me shlyerjen e detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- germa “c”: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE edhe planin për tregtimin, i cili duhet të përmbajë parashikimin vjetor të kostove, shitjeve dhe të të ardhurave për realizimin e kësaj veprimtarie.

- Në lidhje me dokumentacionin e konstatuar të munguar, do të njoftohet shoqëria ta përcjellë atë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Hydro Energy Sotira” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti